VENDIM
Nr. 100, datë 13.9.2013

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRIVE "HEC BISTRICA 1, BISTRICA 2" SHA, "HEC ULËZ SHKOPET" SHA, PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE DHE TË LICENCAVE TË PRODHIMIT, TREGTIMIT DHE FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KËTO SHOQËRI TE SHOQËRIA "KURUM INTERNATIONAL" SHA

Në mbështetje të nenit 9 dhe të nenit 20 pika 1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 17 pika 4 germat "a", "b", "c" të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", pikës 1.3 të licencës së aktivitetit të tregtimit dhe të furnizuesit të kualifikuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e datës 13.9.2013, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërive "Hec Bistrica 1, Bistrica 2" sh.a., "Hec Ulëz Shkopet" sh.a., për transferimin e licencave të prodhimit, tregtimit dhe furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike nga këto shoqëri te shoqëria "Kurum International" sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e shoqërisë "Kurum International" sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo